

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KËSHILI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

**Tiranë, 29.03.2019**

**NJOFTIM PËR MEDIAN**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), me pjesëmarrjen e anëtarëve të tij dhe anëtarëve zëvendësues, të Avokatit të Popullit, të përfaqësuesve nga subjektet e ftuara sipas pikës 2 të nenit 233 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të ekspertëve të EURALIUS, si institucion i ftuar që mbështet me asistencën e tij ligjore përgatitjen dhe miratimin e projektakteve rregullatorë të KED, ditën e sotme 29.03.2019, zhvilloi mbledhjen e radhës, ku në rendin e ditës ishte përcaktuar, vijimi i diskutimeve mbi Projekt Aktet Normative mbi vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për në Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Këshilli, i angazhuar maksimalisht për të përmbushur detyrimet e tij kushtetuese, vendosi vijimin e diskutimeve në lidhje me këtë projekt-akt ditën e martë datë 02.04.2019 ora 12:00.